



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7 regjistër (JR)
Datë 03.02.2022

Nr. 14 i vendimit
Datë 07.04.2023

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 07.04.2023, ditën e premte, ora 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 7/2022 (JR), datë 03.02.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 478, datë 25.11.2021, për subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj.

BAZA LIGJORE: Neni 33 dhe neni 179/b, pikat 2 dhe 5 të Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 6, pika 1 dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; neni 465 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi dhe në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, në parashtrimet e depozituara përpara zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi dhe në seancë gjyqësore, i cili përfundimisht

kërkoi prishjen e vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe kthimin e çështjes për vlerësimin e dy kritereve të tjera, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.
3. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Rexhep Karaj, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë në përfundim të procesit, vendimin nr. 478, datë 25.11.2021.
5. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit, më datë 28.01.2022, ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 478, datë 25.11.2021, protokolluar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 28.01.2022. Komisioni, me vendimin nr. {***}, datë 31.01.2022, ka vendosur pranimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit për vendimin e Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, të cilin e ka konsideruar si ankim të plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
6. Ankimi është regjistruar në Kolegj në Regjistrin e Çështjeve të Juridiksionit të Rivlerësimit me nr. 7/2022 (JR), datë 03.02.2022, në përputhje me nenin 15, pika 2 (a) e rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, brenda afatit të përcaktuar në nenin 18, pika 1 e rregullores së sipërcituar, si dhe është zhvilluar procedura e shortit për caktimin e trupës gjyqësore, kryesuesit dhe relatorit të çështjes, në përputhje me nenin 15, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Me vendimin nr. 478, datë 25.11.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të ankuesit, bazuar në njërin prej kritereve të vlerësimit, atë të pasurisë, konstatoi se subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj: a) ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë, si dhe duke mos bashkëpunuar me Komisionin siç i është kërkuar; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2003 - 2016; c) ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm; d) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; e) nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk i është përgjigjur pyetësorit nr. 3 të dërguar nga Komisioni, si dhe nga veprimet e qëndrimet e tij ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
8. Komisioni, në bazë të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5 të nenit 61, në lidhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në përfundim vendosi: "Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat".

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "Kolegji"), me ankim kundër vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit, duke pretenduar se ky vendim është produkt i një procesi të parregullt ligjor, duke i mohuar ankuesit të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe nuk është i bazuar në provat e administruara nga Komisioni dhe në ato të paraqitura nga ana e subjektit.
10. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, si dhe në parashtrimet shtesë dhe në seancën gjyqësore publike të datës 29.03.2023, paraqiti dhe kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja të disa akteve¹, bazuar në nenet 45, 49 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

¹ Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër për të ardhurat nga pensioni për znj. N. K. (nëna e ankuesit); vërtetim i datës 08.02.2023 i organizatës "{***}", mbi të ardhurat e znj. T. K., kontraktuar si konsultente e jashtme për periudhën 2012-2018; dokumenti "Përmbledhja e daljes", lëshuar më datë 25.11.2021, nga Spitali Rajonal Peshkopi; analizë financiare e përgatitur nga ekspertja kontabël e miratuar, znj. B. H.; procesverbal, mbajtur në ILDKPKI, mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive, i datës 20.01.2014; procesverbal, mbajtur në ILDKPKI, mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive, i datës 31.03.2014; procesverbal marrje në dorëzim, datë 03.02.2022, në kuadër të kontratës së huasë, i cili vërteton se subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj, në cilësinë e huadhënësit, ka marrë një apartament në dorëzim, me një sipërfaqe të caktuar; planimetri apartamenti; urdhër nr. {***}, datë 13.04.2016, i shoqërisë "{***}" Shpk; akt martese midis L. D. dhe L. K., i përkthyer dhe i noterizuar; dokument i emërtuar "Ndihmë shëndetësore për shtetasit joanëtarë në BE", i përkthyer dhe i noterizuar nga gjuha italiane; certifikatë pagëzimi e shtetasit L. K., sjellë e përkthyer dhe e noterizuar nga gjuha italiane, me vërtetim përkthimi nga noteri; deklaratë e tatimit mbi të ardhurat e personit fizik në bazë të deklaramit fillestare, e shtetasit B. A., për vitet 2003-2004, e përkthyer nga gjuha greke dhe e noterizuar; deklaratë e tatimit mbi të ardhurat e personit fizik, në bazë të deklaramit fillestare, e shtetasit Sh. A., për vitet 2003-2004, e përkthyer nga gjuha greke dhe e noterizuar; deklaratë e tatimit mbi të ardhurat e personit fizik, në bazë të deklaramit fillestare të shtetasit V. A., për vitet 2003-2004, e përkthyer nga gjuha greke dhe e noterizuar; dokumenti "Listë e fermerëve Bulqizë", nxjerrë nga faqja web: azhbr.gov.al; tabelë fotografike.

11. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi pranueshmërinë e këtyre akteve në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.
12. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues pranoi në cilësinë e provës, nën dritën e parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, disa nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me përjashtim të vërtetimit të paraqitur nga organizata jofitimprurëse “{***}”, dy procesverbaleve të ILDKPKI-së dhe dokumentit “Listë e fermerëve”. Për sa i përket vërtetimit të datës 08.02.2023, të organizatës “{***}”, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk ka pasur asnjë pengesë për të dorëzuar këtë akt në Komision dhe, për rrjedhojë, vlerësoi që ky akt të mos pranohet në cilësinë e provës, por të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të çështjes duke pasur parasysh prezumimin ligjor. Trupi gjykues vendosi të mos pranojë si provë dy procesverbalet e ILDKPKI-së të datave 20.01.2014 dhe 31.03.2014, pasi akteve u mungon forma ligjore. Ndërsa, për sa i përket dokumentit “Listë e fermerëve Bulqizë”, nxjerrë nga faqja e www.azhbr.gov.al, trupi gjykues vlerësoi se nuk përbën provë, duke qenë informacion nga burime të hapura dhe, si i tillë, mund të aksesohet direkt.

A. Pretendime mbi aspektet procedurale të procesit

13. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor të zhvilluar në Komision, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit si vijojnë.

13.1. Zhvillimi i seancave dëgjimore është bërë pa praninë e subjektit të rivlerësimit, i cili për shkak të gjendjes shëndetësore, ka qenë i shtruar në spital nga data 16.11.2021 deri në datën 25.11.2021. Subjekti ka vënë në dijeni Komisionin në lidhje me gjendjen shëndetësore, si dhe me faktin që ndodhej i shtruar në spitalin rajonal të Peshkopisë, nëpërmjet *e-mail*-ve të datave 17.11.2021, 19.11.2021, 24.11.2021 dhe 25.11.2021. Ky fakt vërtetohet nga dokumenti "Përmbledhje e daljes", dërguar me *e-mail* Komisionit në datën 24.11.2021, në të cilin jepen të dhëna jo vetëm në lidhje me datën e hyrjes e të daljes, por edhe në lidhje me diagnozën e shtrimit, ekzaminimet dhe trajtimet e kryera. Në datë 25.11.2021, subjekti i rivlerësimit i ka dërguar me *e-mail* Komisionit, edhe dokumentin "Raport për paaftësi të përkohshme në punë", së bashku me kërkesën për të shtyrë seancën. Subjekti i rivlerësimit parashtron se vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të hapur me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasi i ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar.

13.2. Në lidhje me vlerësimin e Komisionit se nuk ka qenë bashkëpunues gjatë procesit, subjekti prapëson se gjatë gjithë procesit të rivlerësimit u është përgjigjur në kohë komunikimeve të Komisionit, duke kthyer përgjigje brenda afatit të akorduar. I vetmi rast kur nuk ka kthyer përgjigje, ka qenë për pyetësin nr. 3, të cilin nuk e ka dorëzuar në kohën e duhur, për shkak të një situatë fatkeqësie familjare. Sipas subjektit, përgjigjet e pyetësorit janë dërguar bashkë me shpjegimet e datës 01.11.2021.

13.3. Subjekti pretendon shkelje të parimit të kontradiktoritetit që, si pasojë, ka vënë subjektin në pamundësi për t'u mbrojtur. Komisioni, me vendimin nr. {***}, datë 04.11.2021, ka vendosur riçeljen e hetimit pa e njoftuar subjektin për këtë vendim. Subjekti është vënë në dijeni të ekzistencës së këtij vendimi nga përmbajtja e vendimit nr. 478, datë 25.11.2012, të Komisionit. Në mungesë të njoftimit të vendimit për riçeljen e hetimit, subjekti nuk ka qenë në gjendje të identifikojë shkaqet për të cilat është riçelur hetimi, çfarë veprimesh ka vendosur të kryejë Komisioni dhe nëse janë kryer, si dhe rezultatet e përfituara nga riçelja e hetimit.

13.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon edhe shkelje të barazisë së armëve pasi Komisioni nuk e ka njohur me analizën e re financiare, të përfshirë në vendimin nr. 478, datë 25.11.2021, që ka qenë e ndryshme nga ajo që i është njoftuar ankuesit.

13.5. Lidhur me deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi i Komisionit, për cenim të figurës së gjyqtarit dhe besimit të publikut, është i pambështetur në ligj dhe në prova. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë fizikisht në Shqipëri në kohën e dorëzimit të deklaratës, për shkaqe shëndetësore, dhe plotësimi, nënshkrimi dhe dorëzimi i deklaratës është bërë nga bashkëshortja, e cila nuk ka pasur njohuri për mënyrën dhe llojin e deklarimit. Komisioni nuk pranoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e ekspertimit grafik, si dhe nuk zhvilloi një hetim lidhur me vërtetësinë e argumenteve të paraqitura nga subjekti. Sipas subjektit, deklarimin për herë të parë të pasurisë e ka bërë me deklaratën e vitit 2004, të dorëzuar në vitin 2005.

14. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

14.1. *Lidhur me pasurinë truall dhe shtëpi banimi në {***}, Klos:*

14.1.1. Pronësia mbi këtë pasuri është fituar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore, të dala pas vitit 1990, siç janë ligji nr. 7501 "Për tokën" dhe VKM-ja nr. 432, datë 14.08.1995, "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit".

14.1.2. Arsyetimi i Komisionit se ankuesi ka vetëpërrjashtuar trashëgimtarët e tjerë, nuk qëndron, pasi nuk është një pasuri e fituar me trashëgimi, por e fituar në bazë të ligjit. Përrjashtimi i motrës nuk ka ndodhur për shkak të vullnetit apo ndërhyrjeve të ankuesit, por për shkak të ligjit, pasi nuk ka qenë në përbërjen familjare të ankuesit për shkak të martesës.

14.1.3. Vlerësimi i Komisionit se subjekti nuk arriti të vërtetonte shpenzimet dhe investimet e kryera në vite, është i pakuptimtë për sa kohë që subjekti nuk ka kryer asnjë investim prej më shumë se 30 vitesh.

14.2. *Lidhur me pasurinë tokë bujqësore, me sip. 36.846 m², në fshatin {***}, Bashkia, Klos:*

14.2.1. Gjetjet e Komisionit për këtë pasuri nuk qëndrojnë, pasi bëhet fjalë për një pasuri të poseduar brez pas brezi nga familja e tij. Ky fakt është provuar nga subjekti i rivlerësimit me paraqitjen e vërtetimit, datë 24.10.2007, të Këshillit të Qarkut Dibër, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës", sipas të cilit, në bazë të dokumenteve kadastrale (arkivit) të viteve 1950 - 1952 (pas reformës agrare), z. R. K., nga fshati {***}, disponon 36.846 (tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) m² tokë, sipas ngastrave të ndryshme dhe kufijve të tokës të mirëpërcaktuar.

14.2.2. Duke qenë se toka është zotëruar më parë nga i ati dhe kjo sipërfaqe toke nuk është trajtuar nëpërmjet ligjit nr. 7501 “Për tokën”, posedimi pa titull nga ana e ankuesit, ka vijuar. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me procesin e kalimit në pronësi të tokës bujqësore. Procedura ka nisur me paraqitjen e kërkesës nga ana e subjektit, e cila është miratuar nga Kryesia e fshatit {***}, sipas vendimit nr. {***}, datë 6.10.2020.

14.2.3. Gjetjet e Komisionit për këtë pasuri nuk qëndrojnë, pasi nuk ka arsye që subjekti të bëjë deklaram të pasaktë për një pasuri për të cilën nuk ka shpenzuar para për fitimin e saj, si dhe nuk është bërë asnjë shpenzim apo investim ndër vite.

14.3. Lidhur me huadhënien shoqërisë “{*}” ShPK:**

14.3.1. Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për dhënien e huasë në shumën 50.000 euro, është produkt i një vlerësimi dhe keqinterpretimi të deklarimeve vjetore ndër vite dhe sidomos të vitit 2014.

14.4. Lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga organizata jofitimprurëse “{*}”, pensionit të nënës dhe të të ardhurave të vajzës:**

14.4.1. Për sa i përket mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga punësimi në shoqatën “{***}”, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se sipas legjislacionit në fuqi, tatimi në burim nuk paguhet nga individi. E njëjta logjikë është ndjekur sipas subjektit edhe me të ardhurat e siguruar nga puna e vajzës si farmacistë, nga puna e kryer ndaj një subjekti të licencuar sipas ligjit, të cilat duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

14.4.2. Arsyetimi i Komisionit se dokumenti i paraqitur nga subjekti, për të vërtetuar të ardhurat nga pensioni i nënës, nuk qëndron, nuk plotëson kriteret formale të një dokumenti zyrtar, nuk qëndron pasi subjekti nuk mban përgjegjësi për nivelin dhe profesionalizmin e shkresave që përpilojnë institucionet.

14.5. Lidhur me automjetin tip “Volkswagen-Golf”:

14.5.1. Subjekti kundërshton konkluzionet e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie, pasi në analizën financiare nuk janë përfshirë vlerat në *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore.

14.6. Lidhur me automjetin tip “Ford Fiesta”:

14.6.1. Nuk qëndrojnë përfundimet e Komisionit për pamundësi financiare për blerjen e automjetit, për shkak se në asnjërën prej analizave financiare, nuk janë përfshirë vlerat e parave *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

14.7. Lidhur me automjetin tip “Fiat Punto”, viti i blerjes 2013:

14.7.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se mungon kontrata e blerjes, pasi nëse nuk do të kishte akt blerjeje, nuk do të regjistrohej automjeti. Automjeti është blerë në Itali, sipas kërkesave dhe formave të ligjit italian, dhe blerja është kryer nëpërmjet parave *cash*.

14.8. Lidhur me marrjen e huasë në vlerën 4.000 euro:

14.8.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit, duke parashtruar se nipi i tij ka pasur dhe ka një gjendje financiare shumë të mirë, të arritur në saje të punës së tij në emigracion prej vitit 1992, në Greqi. Të ardhurat e tij për periudhën kur i ka dhënë subjektit huanë, janë të ligjshme pasi ai është emigrant i rregullt në shtetin grek prej vitit 2001.

14.9. Lidhur me metodologjinë e përdorur nga Komisioni për analizën financiare:

14.9.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të udhëtimit nga Komisioni në analizën financiare. Vlera e llogaritur e shpenzimeve mjekësore nga Komisioni, është e pabazuar pasi subjekti ka deklaruar se shpenzimet mjekësore janë mbuluar tërësisht nga shteti italian. Ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në shtetin italian janë mbuluar nga familjarë dhe miq të familjes.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

16. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit në Kolegj

17. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 27.02.2023, vendimin nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin e zhvilluar në Komision dhe me pamundësinë e tij për të marrë pjesë në seancat dëgjimore për shkak të problemeve shëndetësore, dhe pasi verifikoi zhvillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, konstatoi shkelje të rënda procedurale në procesin e zhvilluar në Komision. Për këtë arsye, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr.

84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke i dhënë mundësinë subjektit të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me çështjen e tij. Në këtë mënyrë, Kolegji shëroi të gjitha pretendimet e subjektit lidhur me cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe mosgarantimin e së drejtës për mbrojtje efektive, pasi Komisioni i ka zhvilluar seancat dëgjimore publike pa praninë e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur ky i fundit ishte në pamundësi objektive për të qenë prezent.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

18. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë procesit të zhvilluar ndaj tij në Komision, është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe, si pasojë, ka qenë në pamundësi për t’u mbrojtur. Komisioni, me vendimin e ndërmjetëm nr. {***}, datë 04.11.2021, ka vendosur riçeljen e hetimit pa e njoftuar subjektin për këtë vendim. Subjekti është vënë në dijeni të ekzistencës së këtij vendimi nga përmbajtja e vendimit nr. 478, datë 25.11.2012, të Komisionit. Në mungesë të njoftimit të vendimit për riçeljen e hetimit, subjekti nuk ka qenë në gjendje të identifikojë shkaqet për të cilat është riçelur hetimi, çfarë veprimesh ka vendosur të kryejë Komisioni dhe nëse janë kryer, si dhe rezultatet e përfituara nga riçelja e hetimit.

18.1. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, nga verifikimi i akteve në fashikuj, trupi gjykues vëren se me vendimin nr. {***}, datë 4.11.2021, Komisioni, pasi vlerësoi se duhen kryer hetime të mëtejshme shtesë, ka vendosur të riçelë hetimin administrativ për kriterin e pasurisë. Sipas procesverbalit të mbledhjes së trupit gjykues që shoqëron këtë vendim, u vlerësua riçelja e hetimi pas dërgimit të një shkrese për kërkim informacioni, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në lidhje me pronën ngjitur me pasurinë dykatëshe, në pronësi të subjektit në fshatin {***}, Mat.

18.2. Me *e-mail*-in e datës 12.11.2021, Komisioni ka njoftuar subjektin se pas administrimit të shpjegimeve të tij lidhur me rezultatet e hetimit, trupi gjykues ka vendosur riçeljen e hetimit për kriterin e pasurisë, dhe se do të njoftonte në vijim me ecurinë dhe datën e seancës dëgjimore.

18.3. Sa më sipër, rezulton i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk është njoftuar nga Komisioni për riçeljen e hetimit. Ndërsa, për sa u përket rezultateve të hetimit shtesë, nuk rezulton nga aktet që subjekti të jetë njohur me rezultatet e hetimit, por pavarësisht këtij fakti, trupi gjykues konstaton se ato nuk kanë sjellë asnjë ndryshim në krahasim me rezultatet hetimore që i janë bërë me dije më parë subjektit të rivlerësimit.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve pasi Komisioni nuk e ka njohur me analizën e re financiare, të përfshirë në vendimin nr. 478, datë 25.11.2021, që ka qenë e ndryshme nga ajo që i është njoftuar atij.

19.1. Për sa i përket këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se analiza financiare pjesë e vendimit të Komisionit, është rezultat i të gjithë procesit të kryer në Komision, që përfshin analizën e kryer në kuadër të hetimit, si dhe provat dhe shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë barrës së provës, si dhe gjatë seancave dëgjimore në Komision. Subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatet e hetimit, si dhe me analizën financiare përkatëse, mbi bazën e të cilave ka sjellë provat

dhe ka paraqitur prapësimet e tij. Gjithashtu, subjekti ka pasur dijeni se kjo analizë financiare nuk është përfundimtare, pasi në rezultatet e hetimit, në pikën 23, “Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare”, Komisioni është shprehur se: *Kjo analizë financiare mund të jetë objekt ndryshimi, në varësi të provave dhe shpjegimeve të subjektit për këto rezultate hetimi, si dhe vlerësimin përfundimtar nga Komisioni.* Trupi gjykues vëren se analiza financiare, pjesë e vendimit përfundimtar të Komisionit, i njoftohet subjektit të rivlerësimit së bashku me vendimin, në të cilin jepen argumentet për vendimmarrjen e Komisionit dhe, për këtë arsye, është i pabazuar pretendimi i subjektit se duhej të njihej me të më parë.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi i Komisionit për cenim të figurës së gjyqtarit dhe besimit të publikut, lidhur me dorëzimin e deklaratës periodike të vitit 2003, është i pambështetur në ligj dhe në prova. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë fizikisht në Shqipëri, në kohën e dorëzimit të deklaratës, për shkaqe shëndetësore, dhe plotësimi, nënshkrimi dhe dorëzimi i deklaratës është bërë nga bashkëshortja, e cila nuk ka pasur njohuri për mënyrën dhe llojin e deklaramit. Komisioni nuk pranoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e ekspertimit grafik, si dhe nuk zhvilloi një hetim lidhur me vërtetësinë e argumenteve të paraqitura nga subjekti. Sipas subjektit, deklarimin për herë të parë të pasurisë e ka bërë me deklaratën e vitit 2004, të dorëzuar në vitin 2005.

20.1. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se sipas legjislacionit në fuqi, si në kohën e dorëzimit të deklaratës së vitit 2003, ashtu dhe aktualisht, plotësimi i deklaratës periodike vjetore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, është detyrim ligjor personal i subjekteve deklaruere. Në rastet e pamundësisë objektive të plotësimit të deklaratës, siç është dhe rasti që pretendon subjekti, ai vetë, ose persona të autorizuar prej tij, duhet të kishin bërë me dije ILDKPKI-në në momentin e dorëzimit të deklaratës së parë ose në një kohë të mëvonshme, me qëllim zgjidhjen e situatës. Rezulton se edhe më pas, subjekti nuk ka bërë asnjë veprim për të korrigjuar këtë deklaramit të pavërtetë sipas tij, duke e pranuar në heshtje, dhe ka dalë me këto pretendime vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

*i) Lidhur me pasurinë truall dhe shtëpi banimi në {***}, Klos:*

21. Për sa i përket kësaj pasurie, nga verifikimi i akteve në fashikuj, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për këtë pasuri, ka konkluduar se:
- (i) Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi.
 - (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar origjinën e krijimit të pasurisë, mënyrën e fitimit të pronësisë, statusin aktual, investimet e kryera dhe periudhat e kryerjes së tyre.
 - (iii) Subjekti nuk arriti të provojë burimin e krijimit të kësaj pasurie që rrjedh nga trashëgimia (sipas deklaramit të subjektit), si dhe kohën e ndërtimit të kësaj pasurie.
 - (iv) Ka mospërputhje në lidhje me sipërfaqen ndërtimore të kësaj pasurie, midis deklaratës *vetting* të vitit 2017 dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, pasi subjekti deklaroi se ndërtesa është me sipërfaqe 208 m², ndërkohë që nga hetimi i Komisionit, sipërfaqja e objektit rezultoi 96 m².
22. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: 2.17. *Vendimi nr. {***}, datë 23.8.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat "Për lëshimin e trashëgimisë ligjore të të ndjerit R. K.", përcakton trashëgimtarët që janë përkatësisht, ish-bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij, H. A. (K.) dhe Rexhep*

Karaj. Ky dokument ishte kërkuar me kohë nga Komisioni dhe nuk është vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit gjatë fazës së hetimit administrativ. 2.18. Shpjegimet e subjektit nuk përkojnë me vendimin e gjykatës për lëshimin e trashëgimisë ligjore. Subjekti nuk paraqiti dokumentacion tjetër për të provuar deklaratimet e tij se prona është e trashëguar vetëm në emër të tij dhe të familjes së tij, duke mos përfshirë ligjërisht motrën H. A. (K.). Komisioni e konsideron deklaratim të pasaktë përfitimin vetëm nga ana e tij të kësaj pasurie, duke vetëpërfshirë trashëgimtarët e tjerë ligjorë.

23. Lidhur me vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

23.1. Pronësia mbi këtë pasuri është fituar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore, të dala pas vitit 1990, siç janë ligji nr. 7501 “Për tokën” dhe VKM-ja nr. 432, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.

23.2. Arsytimi i Komisionit se ankuesi ka vetëpërfshirë trashëgimtarët e tjerë, nuk qëndron, pasi nuk është një pasuri e fituar me trashëgimi, por e fituar në bazë të ligjit. Përfshirja e motrës nuk ka ndodhur për shkak të vullnetit apo ndërhyrjeve të ankuesit, por për shkak të ligjit, pasi nuk ka qenë në përbërjen familjare të ankuesit për shkak të martesës.

23.3. Vlerësimi i Komisionit se subjekti nuk arriti të vërtetonte shpenzimet dhe investimet e kryera në vite, është i pakuptimtë, për sa kohë që subjekti nuk ka kryer asnjë investim prej më shumë se 30 vitesh.

24. Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të konkluzioneve të Komisionit, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, konstatoi si më poshtë.

24.1. Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar: *pasuri shtëpi banimi dykatëshe në {***}, Bashkia Klos, me sipërfaqe 208 m², dhe truall 300 m². Trashëgimi familjare. Pjesa takuese 100%. E pavlerësuar. Ndërsa në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: Shtëpi banimi në {***}, sip. banimi 180 m², e paregjistruar, e pavlerësuar. Trashëgim nga babai. Viti i krijimit 1951. Pjesa takuese 100%.*

24.2. Në përgjigje të pyetëorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Shtëpia e banimit është një banesë e ndërtuar në vitin 1928, dykatëshe, që ndodhet në fshatin tim të lindjes (origjina ime dhe e familjes sime) pasuri e prindërve të mi, të cilët aktualisht nuk jetojnë, babai ka vdekur në vitin 1987, ndërsa nëna në vitin 2011. Duke qenë djalë i vetëm i prindërve të mi, bashkë me një motër e cila është e martuar që në vitin 1967, banesa në fjalë është trashëgimi, për shkakun e rrethanave sa më sipër. Bashkëlidhur kam sjellë vërtetimet nga komuna {***} dhe nga zyra vendore e kadastrës Mat. Në kuadrin e regjistrimit dhe azhurnimit të tokës bujqësore, banesa është regjistruar si pasuri e familjes sime, bashkë me një truall prej 300 m².*

24.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetëorit nr. 2, ka paraqitur në Komision aktet:

(i) Vërtetim nga Komuna {***}, datë 10.12.2014, ku deklarohet se Rexhep R. Karaj, lindur në fshatin {***}, ka në pronësi pasurinë nr. {***} në komunën {***}, me një sipërfaqe 300 m², dhe një shtëpi dykatëshe me sip. 208 m².

(ii) Vërtetim me nr. {***} prot., datë 20.05.2021, nga Zyra Vendore e Kadastrës Mat, ku thuhet se Rexhep Karaj ka të regjistruar pasurinë arë+truall, me sip. 300 m² truall, 96 m² ndërtesë në ZK {***}, fshati {***}, Mat.

24.4. Në shpjegimet dërguar Komisionit më datë 01.11.2021 (që sipas subjektit përmbajnë dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 3), subjekti sqaron se: *Regjistrimi i shtëpisë dhe i truallit është bërë në emrin tim, bazuar në Formularin e Trojeve dhe Shtëpive 0001, pasi është ezauruar afishimi publik i këtyre pasurive dhe nuk ka pasur ankesa apo vërejtje nga periudha 18.04.1999 deri më datë 18.07.1999. Kjo pasuri është regjistruar në Zyrën Vendore të Kadastrës Mat më datë 18.07.1999 në favorin tim, pasi unë kam qenë kryefamiljari sipas certifikatës së trungut familjar të vitit 1974. Babai im, R. K. ka ndërruar jetë në vitin 1987. Dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerin, babain tim, është lëshuar me vendimin nr. {***}, datë 23.08.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Ndërsa për motrën, H. A., e cila është martuar në vitin 1967 (kur unë kam qenë 7 vjeç), deklaroj se ajo nuk ka pasur dhe nuk ka disponim real të kësaj pasurie, si dhe nuk ka pasur dhe nuk ka pretendime për pjesë ligjore të kësaj pasurie, vërtetuar edhe me faktin se gjatë fazës së afishimit publik përpara regjistrimit në hipotekë, motra ime H. A. nuk ka paraqitur asnjë ankesë apo vërejtje në lidhje me këtë pasuri. Këtë shtëpi e posedoj vetëm unë me familjen time. Për të provuar mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, ju vë në dispozicion dokumentet e origjinës së kësaj pasurie, që janë përcjellë përmes shkresës nr. {***} prot., datë 26.10.2021, me objekt: “Informacion”, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore e Kadastrës Mat, bashkëngjitur inventari i brendshëm i dosjes, procesverbal i shpalljes publike i datës 18.04.1999, vërtetim i datës 18.07.1999 se nuk ka ankesa apo vërejtje, “Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive nr. {***}”, ku unë Rexhep Karaj jam me nr. rendor {***}, si dhe kartelë pasurie e datës 26.10.2021. Ndërsa, sa i takon sipërfaqes së shtëpisë, në deklaratën vjetore të vitit 2004, kam deklaruar: “Shtëpi banimi në {***}, sipërfaqe e banimit 180 m², trashëgimi nga babai”. Sqaroj se shtëpia është 2-katëshe dhe se sipërfaqja 96 m² i përgjigjet vetëm katit të parë. Ndërsa sa i takon deklaramentit në deklaratën “vetting” 2017, ku është deklaruar: “Shtëpi banimi, 2-katëshe, me sipërfaqe 208 m² dhe një truall me sipërfaqe 300 m², trashëgimi familjare, adresa: fshati {***}, Bashkia Klos”, sqaroj se ky deklarament është bërë në bazë të dokumentit zyrtar “Vërtetim i datës 10.12.2014, të lëshuar nga Komuna {***}”, dokument i cili është depozituar në dosjen përkatëse pranë jush. Kjo pasaktësi në sipërfaqe të shtëpisë, është bërë nga zyrtarët e Komunës {***}, dhe jo nga unë.*

24.5. Bashkë me shpjegimet e datës 01.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 26.10.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore e Kadastrës Mat, si dhe kartelën e pasurisë bashkëlidhur kësaj shkrese, e datës 26.10.2021, sipas të cilave rezultojnë se më datë 21.01.1999, bazuar në formularin e trojeve dhe shtëpive 0001, është regjistruar në emër të Rexhep Karaj, pasuria 96 m², ndërtesë dhe 300 m² truall.

- 25.** Referuar dokumentacionit të sipërpërmendur, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe konkluzioneve të Komisionit, trupi gjykues konstaton se deklaramentet e subjektit për këtë pasuri, janë kontradiktore, pasi në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën e vitit 2004, deklaroi se pasuria është fituar me trashëgimi, ndërsa në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti shprehet për një pasuri që e ka fituar sipas ligjit nr. 7501 dhe VKM-së nr. 432, datë 14.08.1995. Trupi gjykues vëren se pasuria shtëpi banimi në fshatin {***}, sipas deklaramenteve të subjektit dhe provave të paraqitura prej tij, është një pronë shumëvjeçare, e ndërtuar para viteve ‘90, dhe që ka qenë në përdorim të familjes së subjektit prej vitesh. Për shkak të vendndodhjes në një zonë rurale, kjo pasuri si shtëpi banimi, nuk i është nënshtruar regjimit të kolektivizimit dhe ka qenë në pronësi dhe është banuar nga familja e subjektit të rivlerësimit edhe para viteve ‘90.
- 26.** Nga shkresa nr. {***} prot., datë 26.10.2021, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore e Kadastrës Mat, si dhe kartela e pasurisë bashkëlidhur kësaj shkrese, e datës 26.10.2021, trupi

grykues konstaton se regjistrimi i pronës është bërë më datë 21.01.1999², bazuar në formularin e trojeve dhe shtëpive {***}, në emër të z. Rexhep Karaj si bashkëpronar i vetëm. Subjekti ka pretenduar në Komision se regjistrimi është bërë në vitin 1999, në emër të tij si kryefamiljar, sipas certifikatës së trungut familjar të vitit 1974, në të cilën nuk ka qenë e përfshirë motra për shkak të martesës (*pasi ajo është martuar në vitin 1967*). Trupi grykues vëren se baza ligjore së cilës i referohet subjekti në shkaqet e ankimit, nuk e mbështet argumentin e tij si bazë për përfitimin e pronësisë mbi shtëpinë e banimit. Ligji nr. 7501, “Për tokën”, ka pasur si objekt të tij rregullimin e marrëdhënieve mbi tokën, dhe jo atë të shtëpive të banimit apo të truallit mbi të cilat janë ngritur.

27. Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore, lëshuar me vendimin nr. {***}, datë 23.08.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, trashëgimtarë të të atit të subjektit të rivlerësimit janë ish-bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij, H. A. (K.) dhe Rexhep Karaj. Në këtë dëshmi rezulton se kërkuese për çeljen e trashëgimisë ka qenë motra e subjektit të rivlerësimit, H. A.. Gjithashtu, konstatohet se kjo dëshmi është lëshuar që në vitin 2007, dhe megjithëse ishte kërkuar nga Komisioni, nuk është vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit gjatë fazës së hetimit administrativ, sipas kërkesës së pyetësorit nr. 2, dërguar subjektit më datë 10.05.2021, por është paraqitur prej tij në Komision vetëm më datë 01.11.2021. Pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë në vitin 2007, nuk rezulton të jetë kryer nga subjekti i rivlerësimit ndonjë veprim për pasqyrimin apo korrigjimin e pronësisë në favor dhe të bashkëpronarëve të tjerë, sipas kësaj dëshmie.
28. Për sa i përket pretendimit se nëna dhe motra nuk janë bashkëpronare në këtë pasuri, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë heqjen dorë prej tyre nga pasuria në fjalë. (*Nëna ka vdekur në vitin 2011 dhe normalisht duhet të kishte dhe një dëshmi trashëgimie ligjore për pjesën takuese të saj*). Subjekti i referohet dhe konsideron si heqje dorë vetëm faktin që gjatë fazës së afishimit publik përpara regjistrimit në hipotekë, motra e tij H. A. nuk ka paraqitur asnjë ankesë apo vërejtje në lidhje me këtë pasuri. Ndërkohë që konstatohet se kërkesën për dëshminë e trashëgimisë në vitin 2007, e ka bërë motra e tij, rrethanë kjo që tregon se motra e tij ka pasur interes për pasurinë që i takonte me ligj si trashëgimtare e të atit.
29. Në përfundim të sa më sipër, trupi grykues vlerëson se rezulton i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është përfitues i pasurisë sipas përkatësisë në familjen bujqësore, pasi pronësia në këtë shtëpi i përket regjimit të trashëgimisë dhe jo asaj të pronës së fituar me ligjin nr. 7501. Trupi grykues vëren se edhe nëse do të merrej në konsideratë ky pretendim i subjektit, atëherë ai këtë shtëpi duhet ta kishte në bashkëpronësi me nënën, sipas përbërjes familjare të vitit 1974, së cilës i referohet vetë kërkuesi. Në këtë rast, pas vdekjes së nënës në vitin 2011, motra e subjektit të rivlerësimit duhet të trashëgonte si trashëgimtare ligjore, pjesën e saj (për sa kohë që subjekti nuk provon ekzistencën e një testamenti). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë heqjen dorë nga pasuria të bashkëpronarëve të tjerë (nënës dhe motrës), si dhe përfitimin ligjërisht vetëm prej tij të pasurisë shtëpi banimi.
30. Për sa u përket shpjegimeve që subjekti i rivlerësimit jep në ankim në lidhje me mospërputhjet në deklaratimet për sipërfaqen, trupi grykues vëren se Komisioni ka konkluduar për pasaktësi në deklaratim për përfitimin e pasurisë vetëm nga ana e subjektit, ndërsa për gjetjet e tjera ka pranuar shpjegimet e subjektit, ndaj ky nuk përbën shkak ankimi për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, trupi grykues vëren se nuk qëndron dhe shkak i ankimit se është i pakuptimtë vlerësimi i Komisionit që subjekti nuk arriti të vërtetonte shpenzimet dhe investimet e kryera në vite në këtë

² *Procesi i regjistrimit të banesave në fshat ka filluar në vitin 1995, me VKM-në 432, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.*

pasuri, pasi një konkluzion të tillë Komisioni e ka dhënë vetëm gjatë rezultateve të hetimit, por jo në vendimin e tij përfundimtar.

31. Në përfundim, për pasurinë truall dhe shtëpi banimi në {***}, Klos, trupi gjykues çmon se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri, duke vetëpërfunduar trashëgimtarët e tjerë ligjorë.
32. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se nuk ka qenë bashkëpunues, duke prapësuar se gjatë gjithë procesit të rivlerësimit u është përgjigjur në kohë komunikimeve të Komisionit, duke kthyer përgjigje brenda afatit të akorduar. Trupi gjykues konstaton se në vendim, Komisioni ka konkluduar për mungesë bashkëpunimi nga subjekti për mosdorëzimin në kohë të pyetësorit nr. 3, si dhe për shkak të mosdorëzimit prej tij të vendimit nr. {***}, datë 23.8.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat “Për lëshimin e trashëgimisë ligjore të të ndjerit R.K”, lidhur me fitimin e së drejtës të trashëgimisë mbi pasurinë shtëpi banimi në {***}, Klos. Nga shqyrtimi i akteve, rezulton se subjekti i rivlerësimit në komunikimin që ka pasur me Komisionin, me *e-mail*-et e datave 6.10.2021 dhe 12.10.2021, ka kërkuar shtyrje të afatit të dorëzimit të pyetësorit nr. 3, pasi një person i afërm i familjes, ka qenë i sëmurë dhe më pas ka humbur jetën nga Covid-19. Komisioni ka pranuar kërkesën për shtyrje afati, duke përcaktuar datën 12.10.2021 për kthimin e përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, por rezulton se dhe në këtë datë, subjekti nuk është përgjigjur, duke kërkuar përsëri shtyrje afati. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se u ka dhënë përgjigje pyetjeve të pyetësorit nr. 3, në shpjegimet e datës 1.11.2021. Ndërsa vendimi nr. {***}, datë 23.8.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si pjesë e dokumentacionit të kërkuar në mënyrë të përsëritur nga Komisioni gjatë fazës së hetimit administrativ, i është përcjellë këtij të fundit nga subjekti bashkë me përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit të datës 01.11.2021. Në vlerësim të sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë realisht pengesat që ka pasur për mosdorëzimin në kohë të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioni, trupi gjykues çmon të drejtë përfundimin që ka arritur Komisioni se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues për t’u kthyer përgjigje në kohë pyetjeve gjatë procesit të rivlerësimit.

*ii. Lidhur me tokën bujqësore, me sipërfaqe 36.846 m², në fshatin {***}, Bashkia Klos:*

33. Për sa i përket kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në përfundimin se gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumente ligjore të kërkuara nga Komisioni (subjekti nuk i është përgjigjur pyetësorit nr. 3), dhe se subjekti argumentoi se kjo pasuri nuk është pasuri e fshehur dhe është e deklaruar si pasuri e tij.
34. Subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron se gjetjet e Komisionit për këtë pasuri, nuk qëndrojnë, pasi bëhet fjalë për një pasuri të poseduar brez pas brezi nga familja e tij. Ky fakt është provuar nga subjekti i rivlerësimit me paraqitjen e vërtetimit, datë 24.10.2007, të Këshillit të Qarkut Dibër, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sipas të cilit, në bazë të dokumenteve kadastrale (arkivit) të viteve 1950 - 1952 (pas reformës agrare), z. R. K., nga fshati {***}, disponon 36.846 (tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) m² tokë, sipas ngastrave të ndryshme dhe kufijtë e tokës të mirëpërcaktuar. Duke qenë se toka është zotëruar më parë nga i ati, dhe kjo sipërfaqe toke nuk është trajtuar nëpërmjet ligjit nr. 7501 “Për tokën”, posedimi pa titull nga ana e ankuesit, ka vijuar. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me procesin e kalimit në pronësi të tokës bujqësore. Procedura ka nisur me paraqitjen e kërkesës nga ana e subjektit, e cila është miratuar nga Kryesia e fshatit {***}, sipas vendimit nr. {***}, datë 6.10.2020.

35. Lidhur me sa ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues konstaton se ai u referohet dhe kundërshton konkluzionet e Komisionit në përfundim të hetimit administrativ, dhe jo vlerësimin dhe qëndrimin përfundimtar të tij. E vetmja pasojë që i ka dhënë Komisioni subjektit për këtë pasuri, është mungesa e bashkëpunimit, pasi nuk i është përgjigjur pyetësorit nr. 3 dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentet ligjore të kërkuara nga Komisioni. Lidhur me pasurinë tokë bujqësore, në përfundim Komisioni ka vlerësuar se kjo pasuri nuk është pasuri e fshehur dhe është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Prandaj, në konsideratë të konkluzionit përfundimtar të Komisionit, pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit nuk përbëjnë shkak ankimi dhe nuk mund të shqyrtohen nga Kolegji.

iii. *Lidhur me huadhënien shoqërisë “{***}” ShPK:*

36. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Huadhënie shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator Q. D., sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2016. Vlera 50.000 euro. Pjesa takuese 100%. Burimi, kursime familjare.* Ndërsa në DPV-në 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Huadhënie (me qëllim blerjen e një apartamenti), shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator Q. D., sipas kontratës nr. {***} rep., {***}kol., datë 31.12.2016. Vlera 50.000 euro. Pjesa takuese 100%. Burimi nga kursimet familjare.*

37. Për huadhënien në favor të “{***}.” ShPK, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë porosie duke e trajtuar si kontratë huaje, veprim ky që nuk ka pasoja juridike, por në kushtet e një gjyqtari, është e papranueshme një gjë e tillë, duke çuar kështu në cenimin e figurës së tij si gjyqtar. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për dhënien e huas në shumën 50.000 euro, në vitin 2016, pasi ai dhe personat e lidhur rezultojnë në pamundësi financiare, në vlerën 4.577.800 lekë, për vitin 2016. Kjo pamundësi ndryshon nga vlera e rezultateve hetimore, për shkak të mospërfshirjes në analizë të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit në shoqatën “{***}”. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar dhënien e huasë në shumën 50.000 euro, në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

38. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton konkluzionet e Komisionit duke parashtruar se:

38.1. Gjetja e Komisionit për pasojat ligjore të kontratës, është e pabazuar, pasi të gjitha veprimet e kryera midis subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, janë ligjore, në përputhje me Kodin Civil dhe kanë synuar krijimin e pasojave ligjore. Përfundimi i Komisionit se subjekti ka tentuar të fshehtë qëllimin e vërtetë të marrëdhënies kontraktore, nuk qëndron, pasi përmbajtja e kontratës është transparente. Konkluzioni se nëpërmjet kontratës së huasë, subjekti është përpjekur të fshehtë qëllimin e vërtetë të këtij transaksioni, nuk është i drejtë pasi që në nenin 1 të kontratës, “Objekti”, përcaktohet se: *Pala huamarrëse deklaron se ka marrë prej palës huadhënëse, shumën prej 50.000 eurosh, me qëllim kalimin në të ardhmen të pronësisë në favor të palës huadhënëse, të një apartamenti që do të ndërtohet në të ardhmen nga huamarrësi në truallin me sipërfaqe totale 1873,15 m², të ndodhur në Tiranë, ZK {***} [...] Arsyja se përse nuk është bërë nëpërmjet kontratës së porosisë, është për shkak se shoqëria “{***}” ShPK, në momentin e nënshkrimit të kontratës, nuk e kishte nxjerrë akoma lejen e ndërtimit, dhe në rast se nuk do të arrinte të merrte lejen e ndërtimit, kontrata e huasë si titull ekzekutiv, do të garantonte kthimin e shumës së dhënë hua. Pjesë përbërëse e kontratës së datës 31.12.2016, janë edhe kontratat e sipërmarrjes mes pronarëve të truallit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për vënien në dispozicion të truallit. Subjekti i*

rivlerësimit e ka deklaruar huanë, vlerën e saj, mënyrën e pagesës dhe qëllimin për të cilin është dhënë, kontrata është lidhur para noterit dhe nuk ka asnjë arsye pse veprimet e tij janë vlerësuar si të tilla që cenojnë besimin e publikut. Shoqëria “{***}” ShPK është pajisur me leje ndërtimi, të miratuar nga kryetari i bashkisë nr. {***}, datë 14.06.2017, dhe midis subjektit dhe shoqërisë në fjalë do të nënshkruhet një kontratë e re, nëpërmjet së cilës do bëhet kalimi i një apartamenti sipas kontratës së porosisë apo formës së kërkuar nga ligji.

38.2. Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për dhënien e huasë në shumën 50.000 euro, është produkt i një vlerësimi dhe keqinterpretimi të deklarimeve vjetore ndër vite dhe sidomos të vitit 2014, ku gjendja e kursimeve *cash* pakësohet në mënyrë artificiale nga Komisioni, me – 5.250.000 lekë, duke e çuar gjendjen e kursimeve në 800.000 lekë nga 6.850.000 që ka qenë dhe duhej të ishte në të vërtetë. Në analizën e Komisionit, rezulton një keqkuptim i shprehjes “gjendje *cash*”, duke e konsideruar si total progresiv dhe, për rrjedhojë, duke arritur gabimisht në përfundimin për gjendjen *cash* në vlerën 800.000 lekë (zbritur 5.250.000 lekë). Ndërkohë që vlera prej 800.000 lekësh i duhej shtuar gjendjes *cash* të akumuluar deri në vitin 2013, duke e çuar gjendjen progresive të *cash*-it në datën 31.12.2014, në vlerën 6.850.000 lekë. Është e pamundur dhe e pakuptimtë që subjekti të ketë kryer një shpenzim apo investim në vlerën 5.250.000 lekë, në vitin 2014. Në vitet 2015 dhe 2016, janë deklaruar gjendje *cash* dhe në llogari bankare, shuma të cilat kanë qenë kryesisht në bankë, gjë që tregon se pas dhënies së huasë, ankuesi nuk ka pasur më gjendje *cash*. Për këtë arsye, subjekti kërkon nga Kolegji përsëritjen e analizës financiare.

38.3. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që Kolegji të thërrasë si dëshmitar shtetasin Q. D., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, për shkak se Komisioni ka vënë në diskutim mënyrën e kryerjes së pagesës prej 50.000 eurosh.

- 39.** Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim të qëndrimit të Komisionit për cenim të figurës së gjyqtarit, trupi gjykues vëren se kontrata e huadhënies e datës 31.12.2016, pavarësisht se titullohet kontratë huaje, ka në përbërje të saj edhe elementet e një kontrate porosie, ashtu si dhe e pranon vetë subjekti i rivlerësimit. Në këtë rast, trupi gjykues konstaton se kemi të bëjmë me një kontratë në të cilën janë ndërthurur elemente të kontratave të njohura tipike, dhe ku të drejtat dhe detyrimet janë të vendosura lirisht nga palët. Këto lloj kontratash atipike janë të vlefshme dhe të zbatueshme, për sa kohë që nuk bien në kundërshtim me ligjin, siç është dhe kontrata në fjalë, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit ka dashur të rregullojë një marrëdhënie të pritshme porosie, duke zgjedhur formën e huadhënies, si një garanci në rast mospërbushjeje të detyrimit nga pala tjetër, shoqëria “{***}” ShPK. Kontrata është lidhur para noterit dhe është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si në deklaratën periodike 2016, ashtu dhe në deklaratën *vetting*. Nuk rezulton nga hetimi dhe konkluzionet e Komisionit që me këtë kontratë, subjekti i rivlerësimit të ketë tentuar të fshehtë pasurinë apo të kryejë një veprim tjetër në shkelje të ligjit. Në kontratë palët janë shprehur qartë për qëllimin e vërtetë të lidhjes së saj, që është kalimi në të ardhmen i pronësisë së një apartamenti, por që në momentin e lidhjes së kontratës nuk mund të realizohej në formën e një kontrate të mirëfilltë porosie, pasi kushtëzohej nga faktorë të tjerë, jashtë vullnetit të palëve. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se vetëm fakti i zgjedhjes formalisht të një kontrate atipike, nuk mund ta vendosë subjektin e rivlerësimit në kushtet e cenimit të figurës së tij si gjyqtar, siç ka konkluduar Komisioni.
- 40.** Sa i përket konkluzionit të Komisionit se shpjegimet e subjektit në lidhje me kursimet *cash* ishin kontradiktore dhe jobindëse dhe se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huasë në shumën 50.000 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga

Komisioni është keqinterpretuar shprehja “gjendje *cash*”, duke e konsideruar si total progresiv, dhe ky interpretim ka sjellë konkluzionin se në vitin 2014, subjekti ka pasur gjendje *cash* vetëm 800.000 lekë. Sipas subjektit, vlera prej 800.000 lekësh i duhej shtuar gjendjes *cash* të akumuluar deri në vitin 2013, duke e çuar gjendjen progresive të *cash*-it në datën 31.12.2014, në vlerën 6.850.000 lekë.

40.1. Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se subjekti pretendon se deri në fund të vitit 2014, ka pasur gjendje *cash* në vlerën 6.850.000 lekë. Sipas subjektit, ai gjithmonë ka dashur të deklarojë shtesa të vitit në këto kursime dhe asnjëherë gjendje. Pra, sipas tij, çdo vlerë e deklaruar në një vit, i shtohet vlerës së vitit paraardhës, për të arritur në vitin 2014, ku e gjithë shuma e akumuluar në vite, pretendohet se ka qenë 6.850.000 lekë. Nga leximi dhe krahasimi i deklarimeve që ka bërë subjekti në deklaratat periodike vjetore, trupi gjykues vëren se termin “gjendje *cash*”, ai e ka përdorur vetëm në deklarimin e parë të *cash*-it në vitin 2004. Më pas, në vitet e tjera, ai deklaron “para *cash*” apo “kursime nga të ardhurat”, pra rezulton të ketë ndjekur qasjen e deklarimit të shtesave, ndërsa në vitin 2014, deklaron përsëri gjendje *cash* në vlerën 800.000 lekë, që në logjikën e deklarimeve të mëparshme, duhet të jetë totali i gjendjes *cash* që ka pasur subjekti deri në këtë vit.

40.2. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe deklaratimet e tij në deklaratat e viteve 2015, 2016 dhe në deklaratën *vetting* janë kontradiktore. Në deklaratat periodike vjetore 2015 e 2016, subjekti ka deklaruar së bashku likuiditetet në *cash* dhe në sistemin bankar, si: *gjendje “cash”, jashtë sistemit bankar dhe në llogarinë rrjedhëse familjare, të siguruara nga kursimet familjare*, respektivisht në vlerat 1.700.000 lekë dhe 1.500.000 lekë. Ndërkohë, nga verifikimi i të dhënave nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore në vitet 2015 – 2016, mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe në llogari bankare, me totalin e likuiditeteve të vërtetuara me dokumentacionin bankar. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti deklaron gjendje *cash* jashtë sistemit bankar dhe në llogaritë rrjedhëse familjare, në vlerën 1.700.000 lekë. Nga të dhënat bankare, konstatohet se likuiditetet në bankë më datë 31.12.2015, kanë qenë në ekuivalentin në lekë, gjendje prej 1.946.327 lekësh³, pra përafërsisht (me diferencë prej 246.327 lekësh) me gjendjen e likuiditeteve të deklaruara në deklaratën periodike vjetore. Nga këto të dhëna, rezulton se deklarimi i bërë nga subjekti i përket vetëm gjendjes së likuiditeteve në bankë dhe brenda shumës së deklaruar nga subjekti, nuk rezulton të ketë gjendje *cash*. Si rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i subjektit se në fund të vitit 2015, gjendja e likuiditetit *cash* të jetë 6.850.000 lekë. Po kështu, në vitin 2016, referuar deklaratës periodike të këtij viti, subjekti ka deklaruar gjendje *cash*, jashtë sistemit bankar, dhe në llogarinë rrjedhëse familjare prej 1.500.000 lekësh, ndërkohë që konstatohet se likuiditetet në bankë në datën 31.12.2016, kanë qenë në ekuivalentin në lekë, në gjendje prej 1.505.186 lekësh⁴, pra përafërsisht me gjendjen e deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore (me diferencë prej 5.186 lekësh). Nga këto të dhëna, rezulton se deklarimi i bërë nga subjekti i përket vetëm gjendjes së likuiditeteve në bankë dhe brenda shumës së deklaruar nga subjekti, nuk rezulton të ketë gjendje *cash*. Si rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i subjektit se në fund të vitit 2016, gjendja e likuiditetit *cash* të jetë 850.000 lekë. Konstatimet e mësipërme të arritura për vitet 2015 dhe 2016, përkohë edhe me parashtrimin në ankim të subjektit, i cili shprehet se në fund të vitit 2016⁵ nuk ka pasur gjendje *cash*. Në datën 27 janar të

³ Ose 1.826.507 lekë, duke përfshirë balancën negative të gjendjes së overdraftit të vajzës E. K. në Raiffeisen Bank.

⁴ Ose 1.385.554 lekë, duke përfshirë balancën negative të gjendjes së overdraftit të vajzës E. K. në Raiffeisen Bank.

⁵ Në ankim, subjekti shprehet se në vitin 2015 dhe 2016 janë deklaruar gjendje “*cash*” dhe në llogari bankare, shuma të cilat i ka pasur kryesisht në bankë, gjë e cila tregon se pas dhënies së huasë, ankuesi nuk ka pasur më para “*cash*”.

vitet 2017, ai deklaroi gjendje *cash* në vlerën 1.250.000 lekë, që sipas logjikës së mbajtur prej tij në gjithë deklarin *cash* në vite, rezultoi që është shtesë vetëm për periudhën 1 janar - 27 janar 2017.

40.3. Pra leximi në harmoni i deklaratave periodike të viteve 2014, 2015 dhe 2016, për deklarinimet e likuiditeteve *cash*, krijon bindjen se deklarimi në vitin 2014, ka qenë gjendje e likuiditetit *cash* prej 800.000 lekë dhe se subjekti po në këtë deklaratë, ka deklaruar shtesë në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes në Raiffeisen Bank dhe në Credins Bank dhe në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank, të cilat, sipas akteve në fashikuj, përkojnë me shtesat respektive të llogarive bankare. Në vijim, deklarinimet e viteve 2015 dhe 2016 për likuiditetet e deklaruara, për të cilat subjekti ndryshon mënyrën e deklarimit duke i deklaruar së bashku likuiditetet *cash* dhe në bankë, konstatohet se lidhen me gjendjen e likuiditeteve në bankë në fund të vitit, pasi dhe vlerat përafrojnë me gjendjen e likuiditeteve në bankë në fund të vitit.

40.4. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka keqinterpretuar deklarinimet e subjektit për vitet 2014 e në vazhdim, është i pabazuar për shkak të vetë deklarinimeve kontradiktore të subjektit, si dhe të rrethanave të faktit (të dhënave nga bilanci e llogarive).

40.5. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pretendimeve të tij, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtron se është thirrur për të dhënë sqarime pranë ILDKPKI-së, më datë 31 mars 2014, ku është pyetur: "A mund të deklaroni gjendjen e likuiditetit *cash* në fund të vitit 2013, si dhe gjendjen aktuale të këtij likuiditeti?". Kësaj pyetjeje, subjekti i është përgjigjur duke thënë se gjendja e kursimeve të tij familjare *cash* ka qenë 6.000.000 lekë. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka pretenduar këtë sqarim, dhënë ILDKPKI-së, në përgjigjet e rezultateve hetimore, si dhe në fashikujt e Komisionit nuk ka asnjë akt për të vërtetuar këtë sqarim, dhënë nga subjekti ILDKPKI-së më datë 31.03.2014⁶. Por, trupi gjykues vëren se dhe nëse konsiderohet përgjigja e dhënë prej subjektit në procesverbalin e ILDKPKI-së, se gjendja e likuiditetit *cash* më 31 mars 2014, ka qenë 6.000.000 lekë, vlerë e cila është konsideruar në analizën e Komisionit si bilanci e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2013 (sipas leximit të deklaratave periodike të viteve), nuk ndryshon deklarimi i bërë nga vetë subjekti në deklaratën periodike vjetore 2014, se gjendja *cash* (në fund të vitit 2014) është 800.000 lekë.

40.6. Trupi gjykues vëren se pavarësisht se likuiditeti *cash* prej 800.000 lekësh në vitin 2014 konsiderohet shtesë apo është gjendje, vitet më përpara rezultojnë me një bilanci negative prej 3.272.677 lekësh⁷, pra me pamundësi për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruara në disa vite me burime të ligjshme. Bazuar në ndryshimin e mënyrës së deklarinimeve të likuiditeteve në deklaratat periodike 2015 dhe 2016, në formën e deklarimit së bashku me likuiditetet në banka, por dhe në faktin që në përgjigje të rezultateve hetimore për vitet 2015 dhe 2016, subjekti nuk ka konsideruar shtesa në likuiditetin *cash*⁸, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit bëhet i pabesueshëm dhe se huaja është me mungesë burimesh financiare të ligjshme.

⁶ Subjekti ka depozituar në seancën gjyqësore në Kolegji, dy procesverbale të ILDKPKI-së, të cilat nuk janë marrë në cilësinë e provës nga Kolegji, pasi nuk ishin në formën e kërkuar nga ligji.

⁷ Në vitet me bilanci negative, ashtu si është konkluduar dhe nga Komisioni, respektivisht viti 2003, viti 2004, viti 2005, viti 2007 dhe viti 2013, por me bilanci negative më të ulëta pas konsiderimit të të ardhurave nga pensioni i nënës deri në vitin 2011 dhe të të ardhurave të bashkëshortes nga "{***}" (të cilat do trajtohen në vijim).

⁸ Në vitin 2015 e konsideron të barabartë me 2014 dhe 2016, nuk konsideron shtesë, por pakësimin e 6.000.000 lekë (50 mijë euro dhënë hua).

40.7. Trupi gjykues, referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për leximin e deklarimit të likuiditetit *cash* prej 800.000 lekësh në deklaratën e vitit 2014 si shtesë likuiditeti, e konsideroi këtë opsion në analizën financiare të vitit 2014, e cila rezultoi me diferencë pozitive, pra se subjekti dhe personat e lidhur mund ta krijojnë këtë shtesë likuiditeti. Por, nëse leximi i deklaratës së vitit 2014 për deklarimin e likuiditetit *cash* si shtesë, sipas pretendimit të subjektit, do të vijonte dhe me leximin e deklarimeve të viteve në vijim në deklaratat periodike 2015 dhe 2016 të likuiditeteve, (në të cilat likuiditeti *cash* deklarohet së bashku me likuiditetet në llogaritë bankare), pra duke i konsideruar si shtesa likuiditetesh, referuar pretendimit të subjektit kjo do të rezultonte kontradiktore. Subjekti në prapësimet e tij në rezultatet hetimore, po ashtu dhe në analizën financiare paraqitur në parashtrimet në Kolegj, lidhur me likuiditetet *cash* në vitin 2015, nuk ka konsideruar shtesa të tyre, duke mbartur likuiditetet *cash* të akumuluar deri në vitin 2014, dhe në vitin 2016 nuk ka konsideruar shtesa, por pakësim të likuiditetit për vlerën 6.000.000 lekë.

40.8. Në një këndvështrim tjetër, duke konsideruar deklarinimet e likuiditeteve *cash* deri në vitin 2013, prej 6.000.000 lekësh, si dhe pretendimet e subjektit se kjo vlerë është përdorur në vitin 2016 për dhënien e huasë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi të krijojnë këto kursime me burime të ligjshme. Kursimet e mundshme akumulative që mund të krijonte subjekti dhe personat e lidhur deri në vitin 2013, referuar likuiditeteve të deklaruara në deklaratat periodike⁹ dhe rezultateve respektive të analizës së viteve¹⁰ me diferencë negative, sjellin në konkluzionin që subjekti ka pasur kursime të mundshme në *cash*, të krijuara me burime të ligjshme, deri në vlerën 4.608.225 lekë¹¹, vlerë e cila nuk mbulon dhënien e huasë 50.000 euro në vitin 2016.

40.9. Në konkluzion, trupi gjykues çmon se është i bazuar qëndrimi i Komisionit se shpjegimet e subjektit në lidhje me kursimet *cash*, janë kontradiktore dhe jobindëse, duke mos ndryshuar vlerësimin e këtyre kursimeve në analizën financiare përfundimtare.

40.10. Për sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit që Kolegji të thërrasë si dëshmitar shtetasin Q. D., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, për shkak se Komisioni ka vënë në diskutim mënyrën e kryerjes së pagesës prej 50.000 eurosh, konstatohet se Komisioni në vendim është shprehur se: *7.17 Pavarësisht se subjekti nuk solli asnjë dokumentacion provues (transaksion banke, mandat ose ndonjë formë tjetër të parashikuar nga ligji) që vërteton dhënien e shumës prej 50.000 eurosh, shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2016, Komisioni mori të mirëqenë faktin e pagesës jashtë zyrës noteriale, siç ka shpjeguar.* Për këtë arsye, duke qenë se Komisioni e ka konsideruar të mirëqenë faktin e kryerjes së pagesës, trupi gjykues vëren se kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit është e panevojshme.

⁹ Në vitin 2004 prej 500.000 lekësh dhe 4.000 eurosh, në vitin 2005 prej 500.000 lekësh, vitin 2006 prej 300.000 lekësh, vitin 2007 prej 150.000 lekësh, vitin 2009 prej 600.000 lekësh, vitin 2010 prej 500.000 lekësh, vitin 2011 prej 1.000.000 lekësh, vitin 2012 prej 1.200.000 lekësh dhe në vitin 2013 prej 1.300.000 lekësh.

¹⁰ Në vitet 2004 e 2005 me diferencë negative më të mëdha se likuiditetet “*cash*” të deklaruara e nuk mund të krijonte kursimet e deklaruara në “*cash*”; në vitin 2007 me balancë negative e mund të krijonte kursime të mundshme deri në vlerën prej 144.742 lekësh (nga 150.000 lekë deklaruar); në vitin 2013 me balancë negative e mund të krijonte kursime të mundshme deri në vlerën prej 863.483 lekësh (nga 1.300.000 lekë deklaruar).

¹¹ Në vitet 2006, 2009, 2010, 2011, 2012, subjekti dhe personat e lidhur, referuar analizës së viteve me balanca pozitive, mund të krijojnë kursimet në “*cash*”, të deklaruara me burime të ligjshme, prej 3.600.000 lekësh. Shtuar kësaj vlere dhe kursimet e mundshme që mund të krijoheshin me burimet e ligjshme në vitet 2007 e 2013, prej 1.008.225 lekësh (detajuar në poshtëshënimin më sipër), rezulton vlere e kursimeve të mundshme deri në fund të vitit 2013, prej 4.608.225 lekësh.

41. Në vlerësimin përfundimtar të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën 4.508.911 lekë¹², për të justifikuar pasurinë likuiditet të dhënë hua shoqërisë "{***}" ShPK, në shumën 50.000 euro në vitin 2016, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

*iv. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga organizata jofitimprurëse "{***}", dhe të ardhurat nga punësimi i vajzës:*

42. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga puna e bashkëshortes sime T. K., si koordinatorë pranë "{***}"*. *Vlera 5.978 euro.*

43. Në deklaratat periodike vjetore janë deklaruar të ardhurat e bashkëshortes si koordinatorë projekti me organizatën jofitimprurëse (OJF) "{***}" . Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2012, 2013, në total me të ardhurat e saj si inspektore pranë Zyrës Arsimore Mat, të cilat, duke u përlllogaritur, rezultojnë të jenë respektivisht në vlerën 178.000 lekë (ose ekuivalenti ~ 1.280 euro) dhe 172.938 lekë (ose ekuivalenti ~ 1.233 euro) për vitet 2014 -2016, si të ardhura veçmas, respektivisht prej 1.500 eurosh për vitet 2014 dhe 2015, dhe 300 euro për vitin 2016.

44. Komisioni ka vlerësuar se të ardhurat e bashkëshortes nga marrëdhëniet e punës me OJF-në "{***}" nuk mund të konsiderohen të ligjshme sepse nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të pretenduara. Në një marrëveshje me OJF-në, të paraqitur si provë nga subjekti në përgjigje të rezultateve, në klauzolën 5.3 të saj, përcaktohet se *e gjithë përgjegjësia për detyrimet tatimore dhe për sigurimet bie mbi këshilltarin* (bashkëshorten e subjektit që do të ofronte shërbime këshillimi sipas marrëveshjes). Në përfundim, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare përfundimtare të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga OJF-ja.

45. Për sa i përket mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga OJF-ja "{***}", subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se, sipas legjislacionit tatimor në fuqi, tatimi në burim alokohet në buxhetin e shtetit vetëm nga organizata jofitimprurëse të regjistruara dhe ky informacion nuk rezulton në të dhënat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sipas subjektit të rivlerësimit, tatimi në burim nuk paguhet nga individ, prandaj quhet "mbajtje në burim", sepse mbahet aty ku paguhet e ardhura. E njëjta logjikë është ndjekur, sipas subjektit, edhe me të ardhurat e siguruara nga puna e vajzës si farmacistë, nga puna e kryer ndaj një subjekti të licencuar sipas ligjit, dhe duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, të ardhurat e deklaruara nga pagat për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

46. Nga verifikimi i akteve në fashikuj, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit në Komision, i vetmi dokument i paraqitur nga subjekti në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, të datës 1.11.2021, është një kontratë shërbimi (në anglisht) e datës 04.12.2013, e lidhur midis OJF-së "{***}" dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në të cilën parashikohet se T. K. është paguar 333 euro për tre ditë pune si konsulente e pavarur. Në këtë kontratë, parashikohet se konsulenti është përgjegjës për pagesat e taksave, sigurimeve apo çdo kontributi tjetër që lidhet me pagesën sipas kësaj kontrate. Nga lëvizjet e llogarisë së T. K. në Raiffeisen Bank me nr. {***}, bashkëlidhur shkresës që banka i ka dërguar Komisionit, nr. {***} prot., datë 1.6.2020, vërtetohet kryerja e disa pagesave me urdhërues apo dërgues nga "{***}", për llogari të bashkëshortes së subjektit të

¹² Në ndryshim nga diferenca e analizës së vitit 2016, konkluduar nga Komisioni, për shkak të konsiderimit nga Kolegji të të ardhurave të bashkëshortes nga "{***}" .

rivlerësimit. Një ndër pagesat është kreditimi i vlerës prej 300 eurosh më 20.12.2013, me urdhërues “{***}”, e përshkrimi i pagesës¹³ përkon me përshkrimin në aneksin 3 të kontratës së përmendur më sipër. Sipas të dhënave, bashkëshortes së subjektit i kanë kaluar në llogarinë personale në vitin 2013, shuma 600 euro; në vitin 2014 shuma 450 euro; në vitin 2015, shuma prej 283,05 eurosh; në vitin 2016, prej 501,5 euro (në total 1.835 euro), me urdhërues “{***}”, pagesa këto që vërtetojnë se ka pasur një marrëdhënie të bashkëshortes së subjektit me organizatën. Pavarësisht kreditimeve në llogarinë e bashkëshortes, ku evidentohet urdhëruesi, konstatohet se në llogari, gjatë viteve ka dhe kalime të tjera¹⁴, në të cilat nuk evidentohet urdhëruesi apo dërguesi, por që ka indicie se janë nga i njëjti dërgues, pasi në kolonën e përshkrimit të veprimit në lëvizjet bankare, evidentohet një numër që korrespondon me pjesë të numrit të dërguesit në veprimet ku evidentohet dërguesi, organizata “{***}”.

47. Në aktet që ka paraqitur në Kolegj, subjekti i rivlerësimit është dhe një vërtetim i datës 08.02.2023, i organizatës “{***}”¹⁵, firmosur nga drejtoresha A. M., me të cilin konfirmohet se znj. T. K. është kontraktuar si konsulente e jashtme për periudhën 2012-2018, me kontrata shërbimi të veçanta, dhe se pagesat e kryera në llogarinë e saj janë 6.518,55 euro, për të cilat nga organizata “{***}” është paguar detyrimi i tatimit në burim sipas ligjit në fuqi.
48. Në vlerësimin në tërësi të akteve të sipërpërmendura, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit arrin të provojë se bashkëshortja ka përfutuar pagesa nga organizata “{***}”. Nisur nga fakti që subjekti arrin të provojë kalimin e të ardhurave në llogari të bashkëshortes, si dhe nga parashikimet në legjislacionin në fuqi¹⁶, që në rastin e pagesave për shërbimet e konsulencës, tatimi në burim mbahet nga punëdhënësi/kontraktuesi, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e bashkëshortes, në vlerën 5.967 euro (që evidentohen në lëvizjet e llogarisë bankare), konsiderohen si të ardhura të ligjshme, të cilat duhet të përfshihen në analizën financiare përfundimtare të subjektit të rivlerësimit¹⁷.
49. Për sa u përket të ardhurave të siguruara nga punësimi i vajzës, subjekti i rivlerësimit ankimon konkluzionin e Komisionit që nuk i ka konsideruar të ligjshme të ardhurat e deklaruara nga pagat për vitet 2011, 2012 dhe 2013 dhe nuk i ka përfshirë në analizën financiare.
50. Komisioni në vendim është shprehur: *Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka kërkuar të llogaritet si e ardhur edhe paga e vajzës I. K., si farmacistë pranë subjektit person fizik “{***}”, me NIPT {***}, për vitet 2011, 2012 dhe 2013, në shumën 480.000 lekë për secilin vit, kjo edhe sipas deklaratave të këtyre viteve. Formalizimi i marrëdhënies së punës së vajzës me këtë subjekt është bërë në vitin 2016. Pas vlerësimit nga Komisioni, këto të ardhura nuk u bënë pjesë e analizës*

¹³ Me përshkrimin: “PAYMENT FOR ASSESSMENT OF QLE IN SHTERMEN SCHOOLS”.

¹⁴ Në vlerat 900 euro në vitin 2012; 900 euro në vitin 2013; 1.200 euro në vitin 2014; 1.132 euro në vitin 2015 (në total prej 4.132 eurosh) e duke përfshirë dhe ato që evidentohet dërguesi “{***}”, rezultojnë në total prej 5.967 eurosh.

¹⁵ Kolegji vlerësoi që ky akt të mos pranohet në cilësinë e provës, por të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të çështjes.

¹⁶ Në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438 për tatimin mbi të ardhurat, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave (“[...] pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës etj.”), është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës.

¹⁷ Duke korigjuar rezultatet e analizës së Komisionit, në vitin 2012 nga analizë me rezultat negativ në rezultat pozitiv, në vitin 2013 duke e ulur balancën negative në – 436.517 lekë, e në vitin 2016 duke e ulur balancën negative me vlerën 68.889 lekë (ekuivalenten e të ardhurave të bashkëshortes, prej 501,5 eurosh).

financiare për shkak se nuk dokumentohen dhe nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse.

51. Nga aktet në fashikull, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si farmacistë e vajzës sime, I. K.. Vlera 738.592 lekë.* Të ardhurat e deklaruara ndër vite, janë:
 - Në DPV-në e vitit 2011: *Të ardhura nga vajza I. K., punësuar në sektorin privat si farmacistë, 480.000 lekë.*
 - Në DPV-në e vitit 2012: *Të ardhura nga paga e vajzës I. K., e punësuar në sektorin privat, si farmacistë, 480.000 lekë.*
 - Në DPV-në e vitit 2013: *Të ardhura nga paga e vajzës I. K., e punësuar në sektorin privat, si farmacistë, 480.000 lekë.*
52. Në mbështetje të pretendimeve të tij për punësimin e vajzës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës *vetting*, një vërtetim nga subjekti “{***}”, sipas të cilit I. K. ka punuar si farmacistë pranë këtij subjekti për periudhën 16.06.2014 -01.04.2015, si dhe vërtetim nga subjekti “B. R.” për punësimin pranë këtij subjekti nga data 01.04.2015 e në vazhdim (vërtetim i datës 20.01.2017).
53. Nga shkresa e ISSh-së nr. {***} prot., datë 29.05.2020, dërguar Komisionit, jepen të dhëna për pagesat për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale të paguara nga qershori 2014 e në vijim, nga punëdhënësi B. Gj., e më pas nga B. R., për punëmarrësen I. K..
54. Pavarësisht nga sa pretendon, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë punësimin e vajzës për vitet 2011, 2012, 2013.
55. Në vlerësim të akteve sa më sipër, trupi gjyqës konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të ardhurat nga punësimi i vajzës para periudhës qershor 2014, pavarësisht deklarimeve që ka bërë në deklaratat periodike të viteve 2011, 2012, 2013. Këto të ardhura rezultojnë të jenë krijuar në kuadër të një marrëdhënieje informale punësimi dhe, për rrjedhojë, edhe në eventualitetin që do të provohej krijimi i tyre, ato nuk mund të vlerësohen të ardhura të ligjshme duke u përfshirë në analizën financiare të vitit përkatës, për sa kohë nuk përmbushin standardin e përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
 - Në lidhje me pensionin e nënës:
56. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar te seksioni i të ardhurave: *Të ardhura nga pensioni i nënës N. K.. Vlera 550.000 lekë.* Në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga pensioni i nënës së tij, znj. N. K., në deklaratat periodike për vitet 2003-2004 (nuk ka deklaruar për vitin 2005) dhe 2006-2010, në total një vlerë prej 334.000 lekësh.
57. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me shumën e deklaruar si të ardhura nga pensioni i nënës. Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një vërtetim pensioni, dokument i cili, sipas vlerësimit të Komisionit, nuk përmbushte elementet e një dokumenti ligjor për nga pikëpamja formale, për shkak të mungesës së ekstremiteteve të tij, siç janë emri i institucionit, data, numri i protokollit etj., si dhe është një dokument fotokopje dhe jo origjinal. Në përfundim, Komisioni vendosi që të ardhurat nga ky dokument të mos jenë pjesë e analizës financiare të vitit përkatës.

58. Subjekti parashtron në ankimin në Kolegj se ka marrë dijëni për mospërfshirjen e të ardhurave të pensionit të nënës në analizën financiare, vetëm në vendimin përfundimtar të Komisionit. Ky qëndrim i Komisionit është i ndryshëm nga ajo çka i është bërë me dije subjektit të rivlerësimit gjatë procedurës në Komision. Me kërkesë të Komisionit, subjekti ka paraqitur me *e-mail* një dokument justifikues, i cili është pranuar fillimisht nga Komisioni në gjendjen që ndodhej. Në analizën financiare që shoqëron rezultatet e hetimit, kjo e ardhur është përfshirë, ndërsa në vendimin përfundimtar nuk është marrë në konsideratë. Arsyetimi i Komisionit se dokumenti i paraqitur nga subjekti nuk kishte ekstremitetet, si data dhe numri i protokollit, nuk qëndron pasi subjekti nuk mban përgjegjësi për nivelin dhe profesionalizmin e shkresave që përpilojnë institucionet. Komisioni nëse do të donte të hetonte në lidhje me këtë rrethanë, duhet të kishte vënë në dijeni subjektin dhe t'i kërkonte atij paraqitjen e një dokumenti të ri sipas standardeve të pretenduara.
59. Nga verifikimi i akteve në fashikuj, rezulton se në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokument justifikues një ekstrakt, fotokopje, të pensioneve mujore për pensionisten N. I. K., me vulën e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër, në të cilin shkruhet se totali i të ardhurave të pensionit për N. I. K., me numër dosje {***}, për periudhën 01.01.1982 deri më 01.01.2011, janë në masën 550.574 lekë. Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka konstatuar pasaktësi në dokumentin e sjellë nga subjekti i rivlerësimit, duke u shprehur se të ardhurat nga ky dokument, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare të vitit përkatës. Rezultatet e hetimit i janë njoftuar subjektit të rivlerësimit me *e-mail*-in e datës 22.10.2022. Një vërtetim me të njëjtat të dhëna, por në origjinal, dhe me nënshkrimin e një drejtuesi tjetër të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër, ka paraqitur në Kolegj subjekti i rivlerësimit, bashkë me parashtrimet shtesë, më datë 21.02.2023.
60. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me sa më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka marrë dijëni për mospërfshirjen e të ardhurave të pensionit të nënës në analizën financiare, vetëm në vendimin përfundimtar të Komisionit, është i pabazuar, pasi subjekti ka marrë dijëni për këtë konkluzion të Komisionit që në momentin e njohjes me rezultatet e hetimit, ku Komisioni ka konkluduar, lidhur me vërtetimin e pensionit të paraqitur nga subjekti, se: *Në këto kushte, të ardhurat nga ky dokument nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare të vitit përkatës.* Ndërsa, për sa u përket akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Komision, si dhe në Kolegj, konstatohet se pavarësisht se dy vërtetimet e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Dibër, janë të paplota, konstatohet se nga përmbajtja e njëjtë, si dhe nga elementet e tjera, si: vula dhe nënshkrimi i drejtuesit, këto dy akte janë ekstrakte të shkëputura nga akte zyrtare dhe, si të tilla, nga pikëpamja formale, përmbushin kërkesat e një dokumenti ligjor.
61. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, çmon të konsiderojë dhe të përfshijë në analizën financiare, të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit, në vlerën 369.175 lekë, në analizën e viteve 2003-2011¹⁸.
- v. *Lidhur me automjetin tip "Volkswagen-Golf":*
62. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *automjet tip "Volkswagen Golf 3", blerë në vitin 2006, në vlerën 200.000 lekë dhe vlerë zhdoganimi 231.440 lekë. Pjesë takuese: 100%, në bashkëpronësi me djalin A. K . Në DPV-në për vitin 2007, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij*

¹⁸ Duke korrigjuar rezultatet e analizës së Komisionit, në vitet me rezultate negative, duke ulur balancat negative respektivisht në vitet 2003, 2004, 2005 dhe në vitin 2007.

automjeti, në vlerën e blerjes prej 450.000 lekësh. Në të dyja deklaratat nuk jepet burimi i krijimit të kësaj pasurie.

63. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf 3”, për shkak të pamjaftueshmërisë financiare në vlerën 280.278 lekë. Komisioni ka vlerësuar se kursimet *cash* nga viti 2006, nuk mund të përfshihen si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit. Subjekti, në DPV-në e vitit 2007, nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash*, të cilat mund të konsideroheshin si burim për blerjen e këtij automjeti. Përkundrazi, në këtë deklaratë, ai deklaron kursime nga të ardhurat, vlerën 150.000 lekë, vlerë e cila në analizën financiare, është konsideruar si shtesë kursimesh. Vlera e blerjes së automjetit, nga Komisioni është llogaritur në shumën prej 450.000 lekësh, sipas deklaramit të bërë nga subjekti në DPV-në e vitit 2007.
64. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk qëndrojnë konkluzionet e Komisionit pasi në analizën financiare, nuk janë përfshirë vlerat në *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore.
65. Nga aktet në fashikuj, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 6.7.2007, me palën shitëse P. P., për blerjen e automjetit “Volkswagen Golf”, me vlerë 200.000 lekë. Rezulton, sipas deklaratës doganore, të jetë bërë edhe pagesa e vlerës prej 236.350 lekësh, vlerë zhdoganimi më datë 6.9.2007. Sipas kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.11.2011, Rexhep Karaj i dhuron 50% të pronësisë së automjetit tip “Volkswagen”, djalit të tij A. K.. DPSHTRR, me shkresat nr. {***} prot., datë 9.8.2017 dhe 24.7.2017, konfirmon se Rexhep Karaj ka në bashkëpronësi me A. Rexhep Karaj, automjetin me targë {***}, që është me status *çregjistrim i përkohshëm*, të regjistruar në DRSHTRR-në Peshkopi.
66. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues së pari, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit, si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në DPV-në e vitit 2007, duke mos plotësuar detyrimin ligjor për të deklaruar dhe shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave, përcaktuar në mënyrë të shprehur si detyrime, ndër të tjera, në nenin Ç, pika 5, dhe në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me kontrollin e pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se automjeti është blerë në vitin 2007 dhe jo në vitin 2006, siç deklaron subjekti në deklaratën *vetting* dhe se ka pasaktësi në vlerat e deklaruara për blerjen e kësaj pasurie në të dyja deklaratat. Në mungesë të deklaramit të burimit nga ana e subjektit, mbetet e paqartë dhe e paprovuar nëse në blerje janë përdorur kursimet/likuiditetet e deklaruara në *cash* apo të ardhurat e tjera të krijuara për periudhën e blerjes së automjetit, pavarësisht deklarimeve të mëvonshme të subjektit, gjatë hetimit administrativ, për blerjen e automjetit me gjendjen *cash* të vitit 2006.
67. Nga verifikimi i analizës financiare të kryer në Komision, për analizën e periudhës 1.1.2007 – 6.7.2007, duke mos konsideruar përdorimin e likuiditeteve *cash*, deklaruar në deklaratat e mëparshme sipas pretendimit, në kushtet kur nuk ka deklarim burimi si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në DPV-në e vitit 2007, trupi gjykues konkludon për një diferencë negative, ashtu si dhe Komisioni (që ka konkluduar për vlerën prej – 280.278 lekësh), por në vlerë më të vogël (–) 200.943 lekë. Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit deri në datën 06.07.2007, rezultojnë më të larta (në vlerën 455.387 lekë, krahasimisht me vlerën 414.782 lekë të Komisionit), sipas lëvizjeve të

llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank¹⁹, por edhe për shkak se u konsideruan në analizë të ardhurat nga pensioni i nënës²⁰ së subjektit të rivlerësimit, si dhe saktësimi i ndryshimit të likuiditeteve në bankë²¹.

68. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip "Volkswagen-Golf", në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016.

vi. *Lidhur me automjetin tip "Ford Fiesta":*

69. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting: Autoveturë "Ford Fiesta" 1.4 TDCI (viti i prodhimit 2004), blerë në vlerën 204.000 lekë, në bashkëpronësi të T. dhe I. K.. Pjesë takuese 100%*. Në DPV-në 2015, ka deklaruar: *Makinë "Ford Fiesta", vlera 200.000 lekë. Pjesa takuese 100%*. Nuk deklarohet burim i blerjes së automjetit në të dyja deklaratat.
70. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të kundërshtuar konstatimin e bërë nga Komisioni, në lidhje me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare në vlerën 160.244 lekë, për blerjen e automjetit "Ford Fiesta", në vlerën 204.000 lekë, në vitin 2015. Lidhur me pretendimet e subjektit për përfshirjen e gjendjes *cash* si burim për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni ka vlerësuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga subjekti nuk është deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe as në DPV-në e vitit përkatës, përdorimi i gjendjes *cash* si burim për blerjen e kësaj pasurie. Komisioni e ka konsideruar të pabazë pretendimin e subjektit se analiza financiare e vitit 2015, është pozitive dhe kjo justifikon blerjen e automjetit, duke sqaruar se analiza e mundësisë së blerjes së një pasurie bëhet deri në momentin e blerjes së saj. Rezultati i kësaj analize nuk lidhet me rezultatin e vitit 2015. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri.
71. Subjekti në ankim prapëson se arsyetimi i Komisionit për të nxjerrë ankuesin në pamundësi financiare, është gjithmonë i njëjtë. Komisioni në analizën e tij bën një interpretim të sforcuar, duke mos u marrë me mundësinë financiare reale të ankuesit, por arsyeton se pamundësia vjen nga fakti se ai nuk ka deklaruar se blerja e automjeteve është bërë me gjendjen e parave *cash*. Në lidhje me pamundësinë financiare të pretenduar nga ana e Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, përfundimet nuk qëndrojnë për shkak se në asnjërin prej analizave financiare nuk janë përfshirë vlera e parave *cash*. Në çdo DPV të deklaruar nga ankuesi, në fund të vitit është deklaruar kursimi *cash* pas të gjitha shtimeve dhe pakësimeve të ndodhura gjatë vitit. Nuk është parë e arsyeshme dhe as nuk është kërkuar nga ILDKPKI-ja të citohen rastet kur, për shpenzime të ndryshme, është përdorur gjendja *cash*.
72. Trupi gjykues, nga aktet në fashikuj, konstaton se automjeti "Ford Fiesta" është blerë në vlerën 204.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes të datës 24.01.2015, me palë shitëse A. K. dhe palë

¹⁹ Në vlerësim të akteve në fashikuj, referuar lëvizjeve të llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank me nr. {***}, sjellë bashkëlidhur shkresës dërguar Komisionit nga banka, me nr. {***} prot., datë 1.6.2020, janë në vlerën prej 455.387 lekësh (+40.605 lekë në krahasim me Komisionin).

²⁰ Përpjestimore e të ardhurave të pensionit në vitin 2007, prej 49.026 lekësh.

²¹ Të cilat vijnë si pasojë e balancës që Komisioni ka konsideruar për llogarinë e pagës së T. K. në Raiffeisen nr. {***}, se në 6.7.2007 balanca e llogarisë ka qenë 30.300,44 lekë e Komisioni e ka konsideruar 40.400,44 lekë, pasi nuk ka konsideruar veprimin e tërheqjes në ATM, me datë valutë 5.7.2007, por me postim në llogari më 9.7.2007.

blerëse T. dhe I. K.. DPSHTRR-ja, me shkresat nr. {***} prot., datë 9.8.2017 dhe 24.7.2017, konfirmon se T. K. ka në bashkëpronësi me I. Rexhep Karaj, automjetin me targë {***}.

73. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përdorimin e gjendjes *cash* për blerjen e këtij automjeti, trupi gjykues konstaton se në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar: Në DPV/2014: Gjendje “*cash*” – 800.000 lekë – 100 %. Në DPV/2015: Gjendje “*cash*” jashtë sistemit bankar dhe në llogaritë rrjedhëse familjare, të siguruara nga kursimet familjare – 1.700.000 lekë – 100 %.
 74. Nga vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, burimin për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta” dhe, në këto kushte, mbetet e paqartë dhe e paprovuar nëse në blerje janë përdorur kursimet/likuiditetet e deklaruara në *cash* apo të ardhurat e tjera të krijuara për periudhën e blerjes së automjetit, pavarësisht deklaratimeve të mëvonshme të subjektit, gjatë hetimit administrativ, për blerjen e automjetit me gjendjen *cash* të vitit 2006.
 75. Trupi gjykues verifikoi dhe analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 1.1.2015 – 24.01.2015, deri në momentin e blerjes së automjetit, dhe konfirmon konkluzionin e Komisionit se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme, por në një vlerë më të vogël, prej (-)141.096 lekësh²², për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, në vlerën 204.000 lekë, në datë 24.01.2015.
 76. Në përfundim, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip "Ford Fiesta", në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016.
- vii. *Lidhur me automjetin tip “Fiat Punto”, viti i blerjes 2013:*
77. Lidhur me këtë pasuri, nga aktet, rezulton se në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar kjo pasuri dhe as shitja e saj. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti ka deklaruar blerje mjete “Fiat Punto”, në vlerën 150.000 lekë, në emër të vajzës I. K.. Në DPV 2014, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e autoveturës “Fiat Punto” sipas kontratës nr. {***}, nr. {***} kol., datë 17.11.2014, në vlerë 200.000 lekë.
 78. Komisioni ka konkluduar se në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit tip “Fiat Punto”, në vitin 2013. Si rrjedhim, edhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti nuk janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2014.
 79. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se mungon kontrata e blerjes, pasi nëse nuk do të kishte akt blerjeje, nuk do të regjistrohej automjeti. Automjeti është blerë në Itali, sipas kërkesave dhe formave të ligjit italian. Edhe në Shqipëri, me ndryshimet e reja ligjore, shitblerja e automjeteve mund të bëhet pranë zyrave të DSHTRR-së, pa qenë e nevojshme të shkohet te noteri. Për shkak se blerja është bërë në një shtet të huaj, është kryer nëpërmjet parave

²² Pas korigjimit: a) të shpenzimeve të jetesës të rillogaritura, Komisioni ka konsideruar vlerën prej 122.561 lekësh, referuar shpenzimeve të jetesës për familje me 5 persona sipas ILDKPKI-së, me burim INSTAT, për total vitin prej 1.121.380 lekësh, e përpjesëtuar me 12 muaj, rezulton 93.448 lekë; dhe b) ndryshimit të likuiditeteve nga 93.342 lekë, llogaritur nga Komisioni, në 103.306 lekë, si pasojë e kursit të këmbimit për likuiditetet në monedha të huaja, më 24.1.2015 balancën e likuiditetit në euro që ka të njëjtën balancë si më 31.12.2014, Komisioni e ka konvertuar me kursin e këmbimit të vitit 2015, pra duke afektuar balancën e likuiditeteve me kursin e këmbimit.

cash, është e papranueshme që analiza e Komisionit bazohet vetëm në arsyetimin se “nuk është deklaruar që është përdorur para *cash* në blerje”.

80. Lidhur me pretendimet e subjektit për përfundimin e Komisionit se mungon kontrata e blerjes, nga vendimi rezulton se Komisioni e ka nxjerrë këtë konkluzion në rezultatet e hetimit, por në përfundim ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit. Në analizën financiare të Komisionit, është përfshirë si çmim blerjeje, vlera prej 150.000 lekësh, sipas deklaramit të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, duke u pranuar kështu nga Komisioni, blerja dhe rrjedhimisht kontrata e blerjes së automjetit. Prandaj pretendimet e subjektit në këtë drejtim nuk përbëjnë shkak ankimi në Kolegj.
81. Nga verifikimi i analizës financiare për periudhën 01.01.2013 – 03.04.2013, deri në momentin e blerjes së automjetit të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konfirmon konkluzionin e Komisionit se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës, për blerjen e automjetit tip “Fiat Punto”, më datë 03.04.2013, por në një vlerë më të vogël prej 298.409 lekësh²³.
- viii. Lidhur me marrjen e huasë në vlerën 4.000 euro:*
82. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me vlerësimin që i ka bërë Komisioni huasë së pretenduar si të marrë në vitin 2004, nga nipi V. A., trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
83. Në deklaratën *vetting*, nga subjekti i rivlerësimit nuk është deklaruar kjo hua si burim për krijimin e ndonjë pasurie. Në DPV-në 2004, subjekti ka deklaruar: *Gjendje “cash” të nipit emigrant. Vlera 4.000 euro. Pjesa takuese 100%. Viti krijimit 2004. Te detyrimet: euro në përdorim të nipit emigrant V. A., shuma e shlyer 0, detyrimi 4.000 euro.* Në DPV-në 2006, subjekti ka deklaruar: *Kam shlyer një borxh të marrë nga nipi im V. A., të marrë disa vite më parë. Vlera 4.000 euro.*
84. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mundësinë financiare të shtetasit V. A. për dhënien e huasë prej 4.000 eurosh në vitin 2004 dhe përfundimisht kjo shumë nuk u bë pjesë e analizës financiare, për sa kohë nuk kishte burim të ligjshëm. Komisioni vlerësoi se as kthimi i kësaj huaje nuk do jetë pjesë e analizës financiare, meqenëse nuk u vërtetua burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj vlere nga huadhënësi, por edhe për arsye se kjo vlerë nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti i rivlerësimit.
85. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit duke parashtruar se nipi i tij ka pasur dhe ka një gjendje financiare shumë të mirë të arritur në saje të punës së tij në emigracion prej vitit 1992, në Greqi. Të ardhurat e tij për periudhën kur i ka dhënë subjektit huanë, janë të ligjshme pasi ai është emigrant i rregullt në shtetin grek prej vitit 2001.
86. Lidhur me sa më sipër, nga aktet në fashikuj, rezulton se në mbështetje të pretendimit për të ardhurat financiare të shtetasit V. A. nga emigracioni në Greqi, subjekti ka paraqitur, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, një deklaratë të shtetasit V. A., e datës 30.03.2015, në të cilën ai shprehet se përafërsisht 10 vite më parë, i ka dhënë dajës tij një hua prej 4.000 eurosh, të cilat deklaroi se i janë kthyer. Pas kalimit të barrës së provës në Komision, subjekti në përgjigjet e rezultateve

²³ Pas konsiderimit në analizën e periudhës të ardhurat e bashkëshortes nga “{***}”, të përfituara deri më 03.04.2013, sipas lëvizjes së llogarive bankare prej 200 eurosh ose ekuivalenti prej 28.042 lekësh.

hetimore të datës 01.11.2021, ka kërkuar kohë për të paraqitur dokumentacionin për të provuar të ardhurat e huadhënësit, nipit të tij, V. A., por nuk ka depozituar asnjë dokument për këtë qëllim. Ndërkohë në Kolegj, në seancën e datës 29.03.2023, subjekti ka paraqitur tri deklarata të tatimit mbi të ardhurat të personit fizik në bazë të deklaratës fillestare, për shtetasit B. A., Sh. A. dhe V. A., për vitet 2003-2004, të përkthyer nga gjuha greke dhe të noterizuara.

87. Lidhur me aktet e mësipërme, trupi gjykues vëren se pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka sjellë dokumentacion për të provuar punësimin dhe të ardhurat e tre nipërve të tij, në vlerësim të Kolegjit mbeten vetëm aktet në lidhje me nipin V. A., i cili sipas deklarimeve të vetë subjektit, i ka dhënë huanë 4.000 euro në vitin 2004. Nga përmbajtja e këtyre akteve, trupi gjykues vlerëson se mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk arrin të provojë se huadhënësi V. A. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huasë.

ix. Shkaqe ankimi lidhur me metodologjinë e përdorur nga Komisioni për analizën financiare:

88. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në Kolegj mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të udhëtimit nga Komisioni në analizën financiare. Vlera e llogaritur e shpenzimeve mjekësore nga Komisioni, është e pabazuar, pasi subjekti ka deklaruar se shpenzimet mjekësore janë mbuluar tërësisht nga shteti italian.
89. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka llogaritur shpenzime udhëtimi në vlera të konsiderueshme në vite, të cilat kulmojnë në vitin 2013, në vlerën 398.375 lekë. Një shumë e tillë është tërësisht e paargumentuar nga Komisioni, pasi subjekti gjatë dhënies së shpjegimeve, ka sqaruar se gjatë periudhës që ka qenë në shtetin italian, ka qëndruar tek e afërmja e tij L. D. (K.), por Komisioni ka argumentuar se nuk është provuar ky pretendim, pa i kërkuar subjektit ndonjë provë konkrete. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji pranimin e deklaratave të shtetasve L. D. dhe L. D. në lidhje me qëndrimin në apartamentin e tyre në udhëtimin e kryer në Itali në vitin 2013.
90. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nga aktet në fashikuj për shpenzimet mjekësore, trupi gjykues konstaton se:

90.1. Në pyetësin nr. 2, dërguar më datë 10.05.2021, subjektit i është kërkuar të deklarojë dhe vërtetojë shpenzimet mjekësore të ndara sipas viteve, në shtetin italian, dhe nëse janë përballuar nga shteti italian, të paraqesë dokumentacionin provues. Në përgjigje të pyetësit standard dhe të pyetësit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ka marrë trajtim mjekësor jashtë shtetit, me vlerë mbi 1.000 euro, shpenzim i përballuar nga shteti italian.

90.2. Në përgjigjet e rezultateve hetimore të datës 1.11.2021, subjekti është shprehur: *Deklaroj që shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Itali (për arsye mjekësore) janë përballuar nga një mik i familjes sime, dhe për këtë kërkoj kohë që të sjell dokumentacionin provues përkatës. Ndërsa shpenzimet spitalore dhe mjekësore në vitin 2003, janë përballuar nga vetë spitali, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në gjuhën italiane, të përkthyer në shqip [...].*

90.3. Bashkëlidhur pyetësit nr. 2, si dhe më pas në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj, në datën 29.03.2023, subjekti ka paraqitur dokumentin e regjistrimit pranë Shërbimit Shëndetësor (kodi STP, i huaji përkohësisht rezident), të datës 10.11.2003. Nga përmbajtja e aktit, vërtetohet vetëm regjistrimi i subjektit dhe kodi përkatës, dhe nuk ka asnjë të dhënë tjetër për trajtimin mjekësor të tij.

90.4. Trupi gjykues konstaton se subjekti është njohur me kërkesat e Komisionit për të paraqitur dokumentacionin që provonte kryerjen dhe mbulimin e shpenzimeve mjekësore në Itali, pas dërgimit të pyetësorit nr. 2, dhe ka pasur kohën e nevojshme si gjatë procesit të hetimit të kryer në Komision, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të ankimit të tij në Kolegj, që të siguronte dokumentacionin e nevojshëm, dhe është i pabazuar pretendimi i tij se Komisioni nuk i ka dhënë mundësinë për të paraqitur prova në këtë drejtim. Trupi gjykues vëren se pavarësisht pretendimeve për mbulimin e shpenzimeve mjekësore nga shteti italian, subjekti i rivlerësimit, në përfundim, nuk arriti të provojë me akte këto pretendime.

91. Në konkluzion të sa më sipër, në kushtet kur pretendimet e subjektit për mbulimin e shpenzimeve mjekësore nga shteti italian mbeten në nivel deklarativ, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar qëndrimi i Komisionit që në analizë ka përfshirë vetëm vlerën prej 133.650 lekësh, sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard²⁴.
92. Për sa u përket shpenzimeve të udhëtimit, rezulton se në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Ndërsa shpenzimet e udhëtimit gjatë vitit 2013 janë udhëtimet e familjes sime në Itali në këtë vit, të cilat janë përballuar nga kushërira ime L. K.(D.), që jeton në Milano, Itali, dhe për këtë kërkoj kohë të sjell dokumentacionin.*
93. Lidhur me pretendimet se shpenzimet e qëndrimit, fjetjes dhe ushqimit për periudhën e qëndrimit në shtetin italian, janë mbuluar nga familjarë dhe miq të familjes, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj dy dokumente në italisht, të përkthyer dhe noterizuara, akt martese midis shtetases L. D. dhe L. K., certifikatë pagëzimi e shtetases L. K., si dhe fotografi familjare për të vërtetuar udhëtimin dhe qëndrimin e tij dhe të familjes në Itali.
94. Trupi gjykues, pas verifikimit të akteve të sjella në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se ai përsëri nuk arrin të provojë pretendimet e tij për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga të afërmit e tij, për vitet 2005 dhe 2013. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se është e bazuar metodologjia e Komisionit në pasqyrimin e shpenzimeve të udhëtimit në analizën financiare të viteve përkatëse, e cila është mbështetur në metodologjinë sipas jurisprudencës së Kolegjit.
95. Pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit të kryer në Kolegj, duke konsideruar si të drejta disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga pensioni i nënës dhe të ardhurat e bashkëshortes nga OJF-ja “{****}”, subjekti i rivlerësimit sërish gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera familjare, përfshirë edhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme për pasurinë likuiditet të dhënë hua, për periudhën 2003-2016, situatë faktike e cila kualifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
96. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Rexhep Karaj nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke qenë në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 478, datë 25.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

²⁴ Konvertuar në lekë vlera 1.000 euro e deklaruar nga subjekti, sipas kursit të këmbimit për periudhën në fjalë.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Rexhep Karaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 07.04.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi